



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA | REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
AGENCIJA ZA SPREČAVANJE KORUPCIJE
AGENCY FOR PREVENTION OF CORRUPTION



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT / AGENCY FOR PREVENTION OF CORRUPTION
AGENCIJA ZA SPREČAVANJE KORUPCIJE

DATË/A:	21.03.2023	Dep. Nr. Prot. 06/02	Nr. Prot. Prot. No. 627/23
REFERENC-Ë:	DPKI-06-197/23	Nr. Faj. Br. Str. 06	Data Datum 22-03-2023
PËR/ZA/TO:	znj. Vlora SPANCA, Audiore e Përgjithshme, Zyra Kombëtare e Auditimit		
CC:	z. Safet BERISHA, u.d. Drejtor i Përgjithshëm, Zyra Kombëtare e Auditimit znj. Emine SIMNICA - FAZLIU, Ndihmës Auditore e Përgjithshme, Zyra Kombëtare e Auditimit z. Zukë ZUKA, Ndihmës Auditor i Përgjithshme, Zyra Kombëtare e Auditimit		
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Yll BULESHKAJ, Drejtor i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit		
NGA/OD/FROM:	Esad EUPI, Drejtor i Departamentit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit		
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me shqyrtimin e konfliktit të interesit lidhur me konkursin për zgjedhjen e drejtorit të përgjithshëm në Zyrën Kombëtare të Auditimit		

E nderuara znj. Spanca,

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (në vijim: Agjencia), pas informatave të pranuar nga jashtë me dyshimin për konflikt të interesit lidhur me konkursin nr. ref. DP/ZKA/27-12/22, për zgjedhjen e drejtorit të përgjithshëm në Zyrën Kombëtare të Auditimit (në vijim: ZKA), konform kompetencave të saj të përcaktuara me dispozitat e Ligjit nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (në vijim: LPKI), në cilësinë e autoritetit qendror për mbikëqyrjen dhe zbatimin e dispozitave të këtij ligji, në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit dhe nenit 21, paragrafi 1, nënparagrafët 1.4, 1.5, 1.7 dhe paragrafi 2, të LPKI-së, nxjerrë këtë:

OPINION

Është konstatuar se në kuptim të dispozitave të LPKI-së, nuk ka prova të mjaftueshme që argumentojnë dyshimet për ekzistimin e konfliktit të interesit lidhur me konkursin nr. reference DP/ZKA/27-12/22, për zgjedhjen e drejtorit të përgjithshëm në ZKA.

A r s y e t i m

Agjencia ka pranuar dy informata nga jashtë - raportuesi i rastit (DPKI-06-197/23 dhe DPKI-06-197-1/23), me dyshimin për konflikt të interesit lidhur me komisionin për zhvillimin e procedurave të përzgjedhjes së drejtorit të përgjithshëm në ZKA, sipas konkursit nr. ref. DP/ZKA/27-12/22. Ndër të tjera, raportuesi i rastit ka ngritur pretendimet për konflikt të interesit në lidhje me konkursin në fjalë, me dyshimet se:

- *anëtarja e komisionit znj. Emine Simnica - Fazliu është në konflikt të interesit, pasi që njëri nga kandidatët M. S. është kushëri i afërm i saj dhe*

- *znj. Emine Simnica - Fazliu dhe z. Zukë Zuka, kanë qenë anëtarë të komisionit për drejtor të përgjithshëm sipas konkursit nr. reference DP/ZKA/27-12/22, në të cilin z. Safet Berisha është kandidati i parë më i vlerësuar dhe i propozuar nga komisioni për këtë pozitë, ndërsa z. Safet Berisha, kishite qenë anëtar i komisionit për zhvillimin e procedurave të përzgjedhjes së znj. Emine Simnica - Fazliu dhe z. Zukë Zuka, Ndihmës Auditorë të Përgjithshëm sipas konkursit nr. reference RNAP/ZKA/17-08/22.*

Nga shkresat me informata dhe dokumentacion të parashtruara në Agjenci nga raportuesi i rastit, përveç pretendimeve për konflikt të interesit, janë ngritur edhe pretendime tjera lidhur me (pa)rregullsinë e procesit për zgjedhjen e drejtorit të përgjithshëm në ZKA sipas konkursit të sipërpërmendur, si dhe pretendime tjera jashtë sferës së konfliktit të interesit. Mirëpo, Agjencia konform mandatit dhe kompetencave ligjore që ka sipas Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, ka zhvilluar hetimin administrativ duke trajtuar dhe shqyrtuar vetëm pretendimet për konflikt të interesit në kuptim dispozitive të LPKI-së.

Me qëllim të sqarimit të situatës, Agjencia përmes shkresës zyrtare DPKI-06-02/263/23, ka kërkuar nga ZKA informata dhe dokumentacionin lidhur me konkursin për pozitën drejtor i përgjithshëm me numër të referencës: DP/ZKA/27-12/22 dhe për konkursin e datës 22.08.2022, për zgjedhjen e katër (4) ndihmës auditorëve të përgjithshëm. ZKA duke u përgjigjur në kërkesën si më lartë, ka dërguar në Agjenci informatat dhe dokumentacionin e kërkuar (DPKI-06-02/263-1/23).

Gjithashtu, Agjencia me shkresën zyrtare DPKI-06-295/23, ka kërkuar nga Agjencia e Regjistrimit Civil (ARC) informacion lidhur me afërsinë familjare ndërmjet anëtares së komisionit për zhvillimin e procedurave të përzgjedhjes së drejtorit të përgjithshëm znj. Emine Simnica - Fazliu dhe kandidatit M. S. ARC-ja duke u përgjigjur në kërkesën si më lartë, ka dërguar në Agjenci informatën e kërkuar (DPKI-06/295-1/23).

Agjencia ka analizuar në mënyrë të gjithanshme informatat dhe dokumentacionin e pranuar nga raportuesi i rastit, si dhe informatat dhe dokumentacionin e pranuar nga ZKA dhe ARC, të gjitha këto në kuptim të dispozitive të LPKI-së, dhe më pas ka konstatuar gjendjen faktike si në vijim:

- *Konkursi për Drejtor të Përgjithshëm*

Me Vendimin e Auditorës së Përgjithshme nr. protokollit 1666, i datës 24.08.2022, është anuluar konkursi për plotësimin e vendit të punës drejtor i përgjithshëm nr. reference DP/ZKA/16-07-22 i datës 26.07.2022, si dhe është ngarkuar Divizioni për Burime Njerëzore

(i ZKA) që të rishpallë konkursin sipas kushteve të përcaktuara me aktet e brendshme të ZKA-së.

Më datë 24.12.2022, ZKA ka rishpallë konkursin për plotësimin e vendit të punës drejtor i përgjithshëm nr. reference DP/ZKA/27-12/22.

Me Vendimin e Auditorës së Përgjithshme nr. protokoli 038, i datës 11.01.2023, është themeluar Komisioni për zhvillimin e procedurave të përzgjedhjes së drejtorit të përgjithshëm sipas konkursit nr. reference DP/ZKA/27-12/22, në përbërje prej tre anëtarëve (B. H. - kryesues, znj. Emine Simnica Fazliu - anëtare dhe z. Zukë Zuka - anëtar).

Sipas dokumentacionit të pranuar nga ZKA, katër (4) kandidat kanë plotësuar kriteret e konkursit dhe janë ftuar për intervistë, njëri prej të cilëve është tërhequr, ndërsa tre (3) iu kanë nënshtruar procedurave të konkursit. Në mesin e këtyre kandidatëve ka qenë z. Safet Berisha, u.d. Drejtor i Përgjithshëm i ZKA-së dhe M. S. - kandidat i jashtëm.

Komisioni për zhvillimin e procedurave të përzgjedhjes së drejtorit të përgjithshëm, pas zhvillimit të procedurave të vlerësimit të aplikacioneve dhe intervistimit të kandidatëve, me shkresën nr. protokoli 063, të datës 18.01.2023, i ka paraqitur Auditorës së Përgjithshme Raportin për zhvillimin e procedurave të intervistës për pozitën drejtorit të përgjithshëm nr. reference DP/ZKA/27-12/22, përfshirë renditjen përfundimtare sipas pikëve të fituara të tre (3) kandidatëve përmbushin kriteret dhe që mund të konsiderohen për emërim.

Nga lista e renditjes së kandidatëve sipas vlerësimit nga komisioni, shihet se kandidati që ka më së shumti pikë është z. Safet Berisha - u.d. Drejtori i Përgjithshëm i ZKA-së, ndërsa kandidati M. S. është renditur i dyti.

Kundër procesit të vlerësimit dhe rezultateve si më lartë, më datë 24.01.2023, njëri nga kandidatët ka parashtruar ankesë (nr. protokoli 086). Përveç çështjeve tjera të parashtruara në këtë ankesë, janë ngritur edhe dyshimet për konflikt të interesit.

Sipas procesverbaleve dhe dokumentacionet të pranuar nga ZKA, komisioni i ankesave ka filluar me shqyrtimin e ankesës së palës ankuese dhe ka ndërmarrë disa veprime, por me Vendimin nr. protokoli 240, të datës 23.02.2023, ky komision ka shtyrë afatin për shqyrtimin e ankesës për 30 ditë kalendarike, me arsyetimin se, përveç tjerash, konflikti i interesit është njëri ndër pretendimet e ngritura ndërsa ZKA ka marrë informatë se Agjencia është duke e trajtuar këtë çështje.

Në përgjigjjen e ARC-së, lidhur me afërsinë ndërmjet anëtares së komisionit znj. Emine Simnica Fazliu dhe kandidatit M. S., theksohet se [...] *mes personave në fjalë, nuk kemi arritur të vërejmë ndonjë lidhje familjare [...] subjektet në fjalë, por as baballarët e tyre nuk janë fëmijë të axhës [...].* Kjo vërtetohet edhe nga skema e trungjeve familjare për personat në fjalë të paraqitura në përgjigjen e ARC-së, nga e cila konstatohet se gjyshërit e këtyre personave nuk janë vëllezër mes vete, përkatësisht baballarët e tyre nuk janë fëmijë të axhës.

Rrjedhimisht, ndërmjet anëtares së komisionit dhe njërit nga kandidatët për drejtor të përgjithshëm (M.S.), nuk ka lidhje familjare që është brenda shkallës së ndaluar me dispozitat e LPKI-së (gjinia e gjakut - vija e tërthortë - shkalla e katërt).

- Konkursi për Ndhmës Auditor të Përgjithshëm

Me Vendimin e Auditorës së Përgjithshme nr. protokoll 1500, i datës 03.08.2022, ishte anuluar konkursi për plotësimin e vendit të punës Ndhmës Auditor i Përgjithshëm nr. reference NAP/ZKA/13-07-22, si dhe ishte vendosur të përsëritet/rishpallet konkursi sipas kushteve të përcaktuara me aktet e brendshme të ZKA-së.

Më datë 04.08.2022, ZKA kishte rishpallë konkursin për plotësimin e vendit të punës Ndhmës Auditor i Përgjithshëm nr. reference RNAP/ZKA/17-08/22, për katër pozita.

Me Vendimin e Auditorës së Përgjithshme nr. protokoll 1626, i datës 22.08.2022, ishte themeluar Komisioni për zhvillimin e procedurave të përzgjedhjes së Ndhmës Auditorëve të Përgjithshëm sipas konkursit nr. reference RNAP/ZKA/17-08/22, në përbërje pre tre anëtarëve (B. H. - kryesues, z. Safet Berisha - anëtar dhe N. A. - anëtar).

Anëtari i komisionit z. Safet Berisha, njëherit u.d. Drejtori i Përgjithshëm i ZKA-së, është kandidati i parë më i vlerësuar dhe i propozuar nga komisioni për pozitën drejtor i përgjithshëm i ZKA-së, sipas konkursit nr. reference DP/ZKA/27-12/22.

Komisioni për zhvillimin e procedurave të përzgjedhjes së Ndhmës Auditorëve të Përgjithshëm, pas zhvillimit të procedurave të vlerësimit të aplikacioneve dhe intervistimit të kandidatëve, me shkresën nr. protokoll 1725, të datës 08.09.2022, i kishte paraqitur Auditorës së Përgjithshme Raportin për zhvillimin e procedurave të intervistës për katër (4) pozitë Ndhmës Auditorëve të Përgjithshëm nr. reference RNAP/ZKA/17-08/22, përfshirë renditjen përfundimtare sipas pikëve të fituara të kandidatëve përmbushin kriteret dhe që mund të konsiderohen për emërim.

Nga lista e renditjes së kandidatëve sipas vlerësimit nga komisioni, shihet se në mesin e katër (4) kandidatëve që kanë më së shumti poena janë znj. Emine Simnica - Fazliu dhe z. Zukë Zuka, të cilët (më pas) kanë qenë anëtarë të Komisionit për zhvillimin e procedurave të përzgjedhjes së drejtorit të përgjithshëm, ku z. Safet Berisha (anëtar i komisionit këtu), ka qenë kandidati i parë më i vlerësuar dhe i propozuar nga komisioni për pozitën drejtor i përgjithshëm i ZKA-së.

Andaj, në vështrim të gjendjes faktike si më lartë, Agjencia konstatoi si në dispozitiv të këtij opinioni duke u bazuar në dispozitat e nenit nenit 6 lidhur me nenin 17 të LPKI-së.

Konflikti i interesit është i lidhur ngusht me *vendimmarrjen* e zyrtarit në një çështje të caktuar, në të cilën zyrtari ka apo mund të ketë *interes privat* për vete apo të *personave të afërm*. Kështu, me nenin 6 të LPKI-së është përkufizuar nocioni i konfliktit të interesit, ashtu që: “*Konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare*”, ndërsa me dispozitën e nenit 17 [Deklarimi rast për rast i interesave private të zyrtarit], paragrafi 1 të LPKI-së është përcaktuar se: “*Çdo zyrtar gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vetëdeklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij privat ose të personave të afërm me të lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhet shkak për lindjen e një konflikti të interesit dhe të tërhiqet nga kjo vendimmarrje.*”

... lidhur me nenin 3 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të LPKI-së, me të cilin është përkufizuar se: *“interesi privat i personit zyrtar - nënkupton çfarëdo përparësie për personin zyrtar, familjen e tij, të afërmit, miqtë dhe personat apo organizatat me të cilat ai ka pasur apo ka marrëdhënie afariste”,* si dhe me nënparagrafin 1.6 të këtij nenin me të cilin është përkufizuar se: *“person i afërm me zyrtarin është – bashkëshorti ose personi që bashkëjeton, të afërmit në vijë të drejtë të gjakut pa kufizime, të afërmit në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt, adoptuesi, i adoptuari, i afërmi në gjini të krushqisë deri në shkallën e dytë si dhe çdo person fizik apo juridik i cili ka pasur ose ka një lidhje të përbashkët interesi privat pasuror ose jopasuror me zyrtarin [...].”*

Dispozita e nenit 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.12 të LPKI-së, e definojnë nocionin vendimmarrje si: *“çasti i fundit i procesit vendimmarrës gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit apo kontratës si dhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes të cilat janë thelbësore dhe përcaktuese në të cilat pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i zyrtarit përcaktojnë përmbajtjen përfundimtare të aktit apo kontratës si dhe çdo veprim i zyrtarit në ushtrimin e funksionit publik.”*

Në kuptim të dispozitave si më lartë, Agjencia ka konstatuar se pjesëmarrja e znj. Emine Simnica - Fazliu, në cilësi të anëtares së komisionit për zhvillimin e procedurave të përzgjedhjes së drejtorit të përgjithshëm, në të cilin konkurs njëri nga tre (3) kandidatët e vlerësuar, intervistuar dhe rekomanduar ka qenë M. S., nuk paraqet konflikt të interesit. Kjo për faktin se, siç është konstatuar nga përgjigja e ARC-së, ndërmjet personave në fjalë nuk është gjetur të ketë ndonjë lidhje familjare që është brenda shkallës së ndaluar me dispozitat e LPKI-së (gjinia e gjakut - vija e tërthortë - shkalla e katërt). Rrjedhimisht, në kuptim të dispozitës së nenit 3 paragrafi 1, nënparagrafi 1.6 të LPKI-së, personat në fjalë nuk cilësohen si *persona të afërm mes vete.*

Ndërsa, sa i përket pretendimit për konflikt të interesit që, znj. Emine Simnica - Fazliu dhe z. Zukë Zuka, kanë qenë anëtarë të komisionit për drejtor të përgjithshëm sipas konkursit nr. reference DP/ZKA/27-12/22, në të cilin z. Safet Berisha është kandidati i parë më i vlerësuar dhe i propozuar nga komisioni për këtë pozitë, ndërsa z. Safet Berisha, kishte qenë anëtar i komisionit për zhvillimin e procedurave të përzgjedhjes së znj. Emine Simnica - Fazliu dhe z. Zukë Zuka, Ndhmës Auditorë të Përgjithshëm sipas konkursit nr. reference RNAP/ZKA/17-08/22, nuk është gjetur dhe vërtetuar që z. Safet Berisha, znj. Emine Simnica - Fazliu dhe z. Zukë Zuka, të kenë pasur çfarëdo përparsie - interes privat për ‘vendimmarrjet’ e tyre përkatësisht për çështjet në të cilat kanë marrë pjesë.

Për më tepër, nuk janë vërtetuar pretendimet se ‘vendimmarrja’ e znj. Emine Simnica - Fazliu dhe z. Zukë Zuka për zgjedhje të drejtorit të përgjithshëm dhe ‘vendimmarrja’ e z. Safet Berisha për zgjedhje të ndihmës auditorëve të përgjithshëm, të kenë qenë të ndërlidhura dhe/apo të kushtëzuara me njëra-tjetrën.

Agjencia ju rikujton që trupat (organet) vendimmarrëse në procesin e zgjedhjes së drejtorit të përgjithshëm në ZKA, duhet të kenë parasysh dispozitën e nenit 7, paragrafi 3, të LPKI-së, me të cilën është përcaktuar se: *“Personi që ofron informata të bazuara për rastet e konfliktit të interesit gëzon mbrojtje në pajtim me ligjin”,* dhe dispozitën e nenit 9, paragrafi 1, nënparagrafi 1.12 të LPKI-së, e cila parashih se: *“1. Gjatë ushtrimit të funksionit publik zyrtarit i ndalohen këto veprime: [...]; 1.12. të ndërmerë veprime me efekte ndëshkuese apo të bëhet pengesë për*

fitimin e të drejtave të ligjshme të zyrtarëve apo subjekteve që ofrojnë informata për raste të konfliktit të interesit të zyrtarit, personave të lidhur me të ose personave të besuar për këtë shkak”, lidhur me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-085 për mbrojtjen e sinjalizuesve.

Dispozitat e LPKI-së nuk mëtojnë që të kufizojnë apo pengojnë ushtrimin e funksioneve publike, përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësiive ligjore dhe kushtetuese në institucione publike, por përkundrazi, njëri ndër qëllimet e rëndësishme të këtij ligji është funksionimi i institucioneve publike përmes parandalimit të shfrytëzimit të funksionit publik për interesa private, përkatësisht parandalimit të situatave të konfliktit të interesit, duke mbrojtur kështu interesin publik, ruajtur kredibilitetin dhe imazhin e institucioneve publike.

Ky opinion i referohet vetëm situatës konkrete për konflikt të interesit sipas dispozitave të LPKI-së dhe nuk trajton çështje tjera. Agjencia ka trajtuar pretendimet e parashtruara vetëm në kontekst të situatave të mundshme të konfliktit të interesit, ndërsa pretendimet tjera lidhur me (pa)rregullsinë e proceseve për zgjedhjen e drejtorit të përgjithshëm, (pa)përshtatshmërinë e kandidatëve dhe pretendimet tjera që janë jashtë sferës së konfliktit të interesit, përkatësisht jashtë mandatit dhe kompetencave ligjore të Agjencisë, të trajtohen dhe zgjidhen brenda institucionit tuaj apo mekanizmave e institucioneve tjera kompetente.

Agjencia ju falënderon për bashkëpunimin.

Me respekt!